



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

**I- Informacion i përgjithshëm**

*Sa ka qenë financimi nga buxheti i shtetit (në vlerë në miliardë lekë) për vitet 2021, 2022, 2023 për Fondin?*

Tab.1

EMERTIMI	2021				2022				2023			
	cash	peshe specifike (%)	accrual	peshe specifike (%)	cash	peshe specifike (%)	accrual	peshe specifike (%)	cash	peshe specifike (%)	accrual	peshe specifike (%)
buxheti i shtetit	34.9	70.5%	34.9	70.6%	36.6	70.0%	36.6	69.4%	37.0	66.2%	37.0	66.2%
kontributet	14.6	29.5%	14.5	29.4%	15.7	30.0%	16.2	30.6%	18.9	33.8%	18.9	33.8%
<b>Total</b>	<b>49.5</b>	<b>100.0%</b>	<b>49.4</b>	<b>100.0%</b>	<b>52.3</b>	<b>100.0%</b>	<b>52.8</b>	<b>100.0%</b>	<b>56.0</b>	<b>100.0%</b>	<b>56.0</b>	<b>100.0%</b>

**I- Indikatorët e Matricës së Planit të Veprimit të SKSH 2021-2030**

- 1- *Sa është numri i përfituesve nga financimi i paketave shëndetësore në vitet 2021,2022, 2023?*

Tab.2

Viti	Numri i përfituesve të paketave shëndetësore sipas viteve
2021	14,664
2022	17,407
2023	19,344

- 2- *Sa është numri i paketave në shërbimet shëndetësore të blera nga FSDKSH?*

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor”, i ndryshuar, numri i paketave

shëndetësore të financuara nga FSDKSH është 26 paketa shëndetësore të cilat ofrohen në institucione shëndetësore publike dhe jo publike të kontraktuara.

- 3- *A është zgjeruar dhe sa është zgjeruar gama e paketave shëndetësore të financuara 100 % falas nga shteti nga janari 2021 deri në dhjetor 2023?*  
Gjatë periudhës 2021-2023 nuk janë hartuar dhe miratuar paketa të shërbimeve shëndetësore të reja.
- 4- *Sa është numri i kontribuesve aktiv në skemën e sigurimeve shëndetësore në 2021, 2022, 2023?*

Tab.3

Viti	2023	2022	2021
<b>Buxhetor</b>	143,958	143,254	143,195
<b>Jo-Buxhetor</b>	21,616	22,876	20,672
<b>Private</b>	394,746	385,412	373,918
<b>Te vetepunesuar</b>	140,119	135,215	135,695
<b>Fermeret</b>	16,540	14,803	13,857
<b>Vullnetar</b>	11	13	12
<b>TOTAL</b>	<b>716,990</b>	<b>701,573</b>	<b>687,349</b>

- 5- *Sa është përqindja e kontributeve të sigurimeve shëndetësore në totalin e financimit nga FSDKSH?*  
Informacionin e gjeni në Tab.1
- 6- *A janë hartuar/miratuar ndryshime ligjore në Ligjin për Sigurimet Shëndetësore në periudhën janar 2021 deri tani? Nëse po, ku konsistojnë këto ndryshime? Ku është publikuar ligji i ndryshuar (link)?*

Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka pësuar 2 ndryshime gjatë periudhës Janar 2021 dhe deri tani.

- Ndryshimi i parë është bërë me ligjin nr. 87, datë 22.12.2022 “Për një shtesë në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku është shtuar një kategori e re për personat e siguruar. Ky ligj mund të aksesohet lehtësisht në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare (QKB), në linkun: <http://qbz.gov.al/eli/liqj/2022/12/22/87>.

- Ndryshimi i dytë është bërë me ligjin nr. 65, datë 21.07.2023 “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku shtohet një pikë e re tek baza për llogaritjen e kontributeve si dhe janë ndryshuar disa fjalë tek masa e kontributit. Ky ligj mund të aksesohet lehtësisht në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare (QKB), në linkun: <http://qbz.gov.al/eli/liqj/2023/07/21/65-2023>.

7- *Sa është numri I barnave të rimbursueshme për vitin 2020, 2021, 2022, 2023? A janë futur preparate të reja dhe sa preparate në vitin 2021, 2022, 2023?*

Lista e barnave të rimbursueshme 2021 përmban 1191 barna alternativa tregtare, duke mbuluar 90% të diagnozave kryesore, referuar klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve. LBR 2021 është pasuruar me 20 barna të reja (10 prej të cilave përfaqësojnë principe aktive të reja).

Kjo listë është miratuar me VKM Nr.489, datë 30.07.2021, është ende në fuqi.

Lista e barnave të rimbursueshme 2019 (në fuqi deri Korrik 2021) përmbante 1150 alternativa tregtare.